

JOYCE
MEYER

PAQE

HIDH TË GJITHA SHQETËSIMET MBI TË

PAQE

PAQE

Hidh të Gjitha Shqetësimet mbi Të

JOYCE
MEYER



Tiranë

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, Versioni ABS. E drejta autorit © 2002 nga Albanian Bible Society. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përdorur me leje.

Në raste të tjera të përdorimit të citimeve biblike, informacioni jepet menjëherë pas përdorimit të tyre.

Botim i Joyce Meyer Ministries

© 2011 nga Joyce Meyer

P.O.Box 655

Fenton, Missouri 63026

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç rasteve të lejuara në ligjin mbi të drejtat e autorit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të shpërndahet, apo të transmetohet në asnjë formë apo mjet, apo të ruhet në një bazë të dhënash ose sistem rikthimi kompjuterik, pa pasur më parë miratimin e shkruar të publikuesit.

Përktheu: Eriselda Radovicka

Redaktori: Sedika Fushekati dhe Iva Çipuri

Layout: Gjergji Kollumbi

Shtypur në: AGStudio.al

Emri dhe logoja e Joyce Meyer Ministries janë shenja dalluese me të drejta ekskluzive të kësaj shërbese.

PËRMBAJTJA



<i>Parafjalë</i>	vii
1. A Po Shijoni Paqe?	1
2. Si ta Gëzoni Paqen	7
3. Lëreni Paqen T'ju Udhëheqë	13
4. Kush Janë Vjedhësit e Paqes?	19
5. Përse Djalli Përpiqet të Vjedhë Paqen Tuaj?	25
6. Qëndrimi i Besimtarit Gjatë Provave	33
7. Ditë Pas Dite	41
8. Lutja Sjell Paqe	49

PARAFJALË



“..... të kërkojë paqen (harmoni; mosshqetësim nga frika, pasionet tunduese dhe konfliktet morale) dhe ta ndjekë atë. [Mos dëshironi thjesht marrëdhënie të paqta me Perëndinë, me partnerin tuaj dhe me veten, por këmbëngulni, shkoni pas tyre] 1 Pj. 3:11.

Unë lutem që ky libër mbi paqen do t’ju ndihmojë që të mësoni të shijoni “... paqen e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarsie ...” (Fil. 4:7).

A PO SHIJONI PAQE?



1



A PO SHIJONI PAQE?

Çdo fëmijë i rilindur i Zotit duhet të shijojë një jetë plot me paqe. Jezusi tha tek Gjoni 14:27

“Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë. [Mos e lejoni veten të frikësoheni dhe të shqetësoheni; dhe mos e lejoni veten të jeni të trembur e ngurrues, të frikësuar e të pavendosur.]”

Ky është me të vërtetë një varg i fuqishëm. Ju lutem lexojeni atë disa herë dhe pastaj rrini pesë minuta duke medituar për të dhe lejojuni t’ju depërtojë.

Fillimisht, vini re se paqja që ofron Jezusi është një paqe e veçantë, jo si ajo që jep bota. Çfarë lloj paqeje ofron bota? Bota ofron një *ndjenjë* të caktuar të paqes. Kjo paqe funksionon kur çdo gjë në jetën tuaj shkon sipas rrugës që ti do të doje. Megjithatë, kur gjërat nuk shkojnë sipas mënyrës suaj, ajo paqe e botës zhduket me shpejtësi. Menjëherë të pushton fryma e “mërzitjes”.

Paqja që jep Jezusi, vepron në kohë të mira dhe të këqija, kur je lart ose poshtë. Paqja e tij vepron në mes të stuhisë.

Do të ishte e mrekullueshme, për aq sa i përket mendjes fizike, nëse çdo gjë do të shkonte sipas mënyrës tuaj gjatë gjithë kohës. Nga përvoja, ne e dimë se në jetën reale kjo gjë nuk ndodh. Si besimtare, unë u përpoqa për vite të përdor besimin tim të zhvendos diçka dhe gjithçka që nuk pëlqej apo që nuk ishte e mirë. Kjo më shkaktonte mërzitje të jashtëzakonshme.

Të përpiqesh të bësh diçka të ndodhë, diçka e cila nuk mund dhe nuk do të ndodhë, është gjithmonë shumë e mërzitshme. Pasi fitova pak përvojë me Zotin, më në fund fillova të mendoj se duhej të përdorja besimin tim për të kaluar qetësisht dhe paqësisht përmes stuhive dhe sprovave të jetës. Unë duhej ta ndaloja djallin të më vidhte paqen sa herë që kthehesha nga ana tjetër.

Jezusi thotë tek Gjoni 14:27 (AMP) “Mos e lejoni veten të frikësoheni dhe të shqetësoheni.” Sa më shumë e lexoja këtë shkrim dhe mendoja për të, aq më shumë kuptoja se Bibla po më tregonte se po ia bëja këtë gjë vetes. Duhej të ndaloja. Ai gjithashtu thotë në atë varg: “zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë.”

Jezusi i qortoi dishepujt tek Marku 4:40 për mungesë besimi sepse ata humbën paqen gjatë stuhisë. Jezusi nuk e humbi paqen e tij. Ai ishte në gjumë në fund të varkës. Dishepujt ishin në panik dhe shumë të mërzitur.

Po ti? A do të kishe qenë në fund të varkës duke shijuar paqen me Jezusin? *Në qoftë se nuk keni paqe, nuk po e shijoni jetën.*

SI TA GËZONI PAQEN



2



SI TA GËZONI PAQEN

Asnjë mesazh nuk është shumë ndihmues nëse nuk na jepen disa udhëzime “si të” arrijmë atë për të cilën kemi nevojë. Të thuash se ke nevojë për paqe është hapi i parë. Megjithatë, pa ndarë praktikisht se si mund të kemi paqe, me të vërtetë nuk kemi për të pasur asnjë fryt.

Një gjë që më ndihmoi shumë të filloja të shijoja një jetë të paqtë ishte kur kuptova se ishte e kotë dhe jashtëzakonisht e pashpresë të “përpiqesha të bëja diçka për të cilën nuk mund të bëja asgjë”. A po e bëni edhe ju këtë gjë? A po e mërzisni veten duke u përpjekur t’i bëni gjërat të ndodhin? Zoti ka një kohë të përsosur për çdo gjë dhe ju duhet të prisni për kohën e Tij.

Në përgjithësi nuk mund t’i bëni gjërat të ndodhin jashtë kohës së tyre. Edhe nëse krijoni diçka jashtë kohës së vet, nuk do të ishit kurrë të lumtur me të. Mësoni të prisni në Perëndinë. Kjo i sjell Atij nder dhe juve paqe.

A po përpiqeni të bëni të pamundurën? A po përpiqeni t'i ndryshoni njerëzit rreth jush- ndoshta personin me të cilin jeni martuar, një prej fëmijëve ose ndonjë të afërm? Njerëzit nuk mund t'i ndryshojnë njerëzit. Vetëm Perëndia mund të futet në zemrën e një personi dhe t'i japë atij/ asaj dëshirën për të ndryshuar. Nëse i detyrojmë njerëzit duke iu parashtruar atyre kërkesa, do të përfundojmë duke vjedhur paqen e çdokujt. Ne nuk jemi krijuar për t'u vendosur nën ligj. Njerëzit kanë nevojë për liri. Ata kanë nevojë për hapësirë në të cilën të mund të lëvizin.

Gjatë viteve të para të martesës, u përpoqa ta ndaloja Dave të luante golf. Mendoja se ai luante jashtëzakonisht shumë dhe doja të kaloja më shumë kohë me të. U përpoqa në çdo mënyrë që dija, përdora çdo variant, vara buzët, u inatosa, u përpoqa ta bindja, nuk i fola për ca kohë. Asgjë nuk funksionoi. Isha e mërzhitur gjatë gjithë kohës. Herë pas here, ai hiqte dorë dhe nuk luante për njëfarë kohe. Ishte interesante që edhe pse arrija atë që doja, ende nuk kisha paqe. Nuk kisha paqe sepse u përpoqa të arrija atë që doja në mënyrën e gabuar. Nëse po përpiqeni të detyroni dikë të ndryshojë, do të vidhni paqen tuaj.

A jeni shumë të mërzhitur me veten sepse frymërisht nuk jeni atje ku do të donit të ishit? A po përpiqeni të ndryshoni vetveten?

Sigurisht që duhet të bashkëpunoni me Frymën e Shenjtë në lidhje me punën që Ai po bën në jetën tuaj. Ai po ju çon në përsosmëri ose në maturim. Ju nuk mund ta bëni vetë këtë gjë. Kjo është një tjetër fushë ku përpiqeni të bëni diçka të cilën nuk mund ta bëni dot.

Jam e sigurt se e shihni se është diçka tepër e natyrshme të përpiqeni t’i ndryshoni gjërat që nuk ju pëlqejnë. Jini realistë për një moment. Sa të suksesshëm jeni në ndryshimin e këtyre gjërave? A jeni thjesht duke u irrituar dhe duke humbur paqen tuaj ndërkohë që duhet të pushonit në Perëndinë, duke pritur në Të dhe kohën e Tij, duke i besuar Atij me njerëz të tjerë në jetën tuaj madje edhe me veten tuaj?

Më lejoni ta përmbledh duke thënë këtë: nëse jeni “duke u përpjekur të bëni diçka për të cilën nuk mund të bëni asgjë,” do të shqetësoheni dhe nuk do ta gëzoni paqen.

**LËRENI PAQEN
T'JU UDHËHEQË**



3



LËRENI PAQEN T'JU UDHËHEQË

Kolosianëve 3:15 (AMP) thotë:

“Dhe lejoni që paqja (harmonia shpirtërore që vjen) e Krishtit të mbretërojë (të veprojë vazhdimisht si gjyqtar) në zemrat tuaja [duke vendosur dhe stabilizuar në përfundim të gjitha pyetjet që ngrihen në mendjet tuaja . . .].”

Gjyqtari i një loje me top vendos nëse ju jeni brenda apo jashtë. Paqja duhet të jetë gjyqtari që vendos nëse diçka duhet të jetë brenda apo jashtë jetës suaj.

Shumë njerëz nuk e shijojnë paqen sepse janë jashtë vullnetit të Perëndisë. Ata ndjekin vullnetin e tyre dhe jo atë të Perëndisë. Ata bëjnë atë çka ndjejnë se duhet të bëjnë ose atë që mendojnë se është e drejtë në vend që të ndjekin Fjalën e Perëndisë e të udhëhiqen nga paqja. Shumë shpesh del diçka që unë dua ta bëj. Ajo mund të tingëllojë mirë, të bën të ndjehesh mirë dhe madje mund të jetë një gjë e mirë. Megjithatë, nëse nuk kam paqe, kam mësuar të heq dorë prej saj.

Lëreni paqent t'ju udhëheqë. Mos blini diçka, veçanërisht nëse është një blerje e madhe, nëse nuk keni paqe për të. Pavarësisht sesa shumë e dëshironi atë gjë, do të ndjeheni keq nëse veproni kundër drejtimit të Frymës së Shenjtë.

Herë pas here më ofrohej mundësia për të folur në ndonjë takim dhe mua do të më pëlqente ta bëja, por nuk ndjeja paqe në lidhje me të. Nuk e di përse, por ndonjëherë thjesht nuk kisha paqe. Kam mësuar se nëse pranoj të shkoj dosido, gjithmonë më del një arsye pse duhej të ndiqja paqen.

Më kujtohet një ftesë kur sapo kisha filluar të udhëtoja. Ftesat për të folur ishin të pakta, larg njëra-tjetrës dhe natyrisht unë doja t'i pranoja të gjitha. Mora një ftesë nga një kishë në Teksas dhe isha shumë e entuziazmuar në atë kohë. Thashë “po” menjëherë. Dy javë më vonë, më brente nga përbrenda sa herë që mendoja për të. Kjo ndjenjë u bë gjithnjë e më e fortë. Ishte e qartë se nuk ndjeja paqe për të shkuar, e megjithatë Perëndia nuk më jepte arsye përse.

Unë prita e prita. Së fundmi, e dija se duhej t'u telefonoja dhe t'ju kërkoja të më lironin nga ai përkushtim. U thashë se mund të vija vetëm nëse nuk do të mund të gjenin një zëvendësim të përshtatshëm, e megjithatë, pa ndonjë arsye të caktuar nuk kisha paqe për të shkuar atje. Ata më liruan nga përkushtimi.

Disa javë më vonë zbulova se kisha ime do të përkushtonte ndërtesën re pikërisht atë fundjavë që nuk do të isha aty. Unë kisha qenë ndihmës-pastore në atë kishë për goxha kohë para se të filloja shërbesën time dhe ishte shumë e rëndësishme për mua të isha me ta në atë ngjarje.

Përse Zoti nuk më tregoi se çfarë po ndodhte? Ai zgjodhi të mos më tregonte për disa arsye. Fjala e tij na thotë të udhëhiqemi nga paqja. Shumë herë, kjo është gjithçka që Ai do t'ju japë për t'ju bërë të ditur nëse jeni “brenda” apo “jashtë” vullnetit të Tij. Më vonë mund të mësoni arsyen pse, ose kurrë mund të mos e merrni vesh pse-në.

Ju nuk do të gëzoni një jetë të paqtë nëse nuk i bindeni udhëheqjes së Tij por ndiqni vullnetin tuaj.

**KUSH JANË
VJEDHËSIT E PAQES?**



4



KUSH JANË VJEDHËSIT E PAQES?

Çdo individ bezdiset nga disa gjëra të caktuara. Satani ka kaluar të gjithë jetën tuaj duke ju studiuar. Ai ndoshta ju njeh më mirë seç e njihni ju vetveten. Ai e di se çfarë ju bezdis. *Ju duhet të dini se cilat janë ato gjëra që ju bezdisin dhe të tregoheni të kujdesshëm në ato periudha kohe që të mos e humbisni paqen.*

“Vjedhësit e paqes” nuk janë të njëjtë për të gjithë. Ka disa gjëra që më bezdisin mua, por aspak Dave. Për shembull, mua më pëlqen qetësia, por atë nuk e bezdis fare zhurma. Ai mund të lexojë një libër ndërsa një prej vajzave tona ka ndezur magnetofonin me volum maksimal dhe djali ynë nëntëvjeçar kacafytet me qenin në dysheme.

Mua nuk më pëlqen të nxitoj dhe urrej të jem me vonesë. Ndonjëherë Dave përpiket të bëjë shumë gjëra në të njëjtën kohë dhe ne përfundojmë duke nxituar në minutën e fundit.

Djalli e di këtë gjë për mua dhe ai do ta përdorë duke u përpjekur të më vjedhë paqen. Dave, nga ana tjetër, sa herë që na duhet të fluturojmë, dëshiron të shkojmë në aeroport të paktën një orë më herët. Ai gjithmonë dëshiron të shkojë herët në kursin e golfit kur do të luajë golf. Në qoftë se djalli bën që ai të jetë vonë në një prej këtyre ngjarjeve, Dave fillon ta humbasë paqen e tij.

Ne jemi të ndryshëm, prandaj Satani përdor taktika të ndryshme për secilin prej nesh. Jini më të zgjuar se ai. *Ai ju kurdis që të mërzhiteni*. Kush janë “vjedhësit e paqes” suaj? Bëni një listë dhe diskutojeni atë me familjen tuaj. Zbuloni se cili është faktori që i acaron ata shumë, pastaj përpiquni të ndihmoni njëri-tjetrin t’i shmangni këta faktorë.

Dave është një lojtar serioz golfi. Edhe unë luaj, por jam rehat edhe kur vetëm qesh dhe nënqesh gjatë lojës së golfit. Gjithsesi, kam mësuar se nuk tregohem e urtë kur tallem gjatë kohës që luaj golf me Dave apo kur e ngacmoj kur bën një goditje të gabuar. Ne kënaqemi, por unë duhet të bëj atë që është e pranueshme për të. Nuk ka kuptim ta bësh dikë të humbasë paqen e tij/saj. Kur jeton me dikë për një kohë të gjatë, fillon t’i njohësh dobësitë e tij/saj si edhe të tuat. Po e përsëris: “Përpiquni ta ndihmoni njëri-tjetrin t’i shmangni këta faktorë.”

Dave më ndihmon mua në dobësitë e mia. Ai ndihmon në mbajtjen e qetësisë kur unë përpiqem të studioj apo të pushoj. Ai më inkurajon të çlodhem dhe të argëtohem sepse ai e di se nëse lodhem shumë, Satani do të më vjedhë paqen. Galatasit 6:2 (ABS) thotë: “Mbani barrët e njëri-tjetrit . . .” Ne duhet t’i durojmë dobësitë e njëri-tjetrit, të kuptojmë se të gjithë ne kemi dobësi me tepri dhe të lutemi për njëri-tjetrin.

**PËRSE DJALLI PËRPIQET
TË VJEDHË PAQEN TUAJ?**



5



PËRSE DJALLI PËRPIQET TË VJEDHË PAQEN TUAJ?

Ne e dimë se paqja na lidh me Frymën e Shenjtë. E thënë në një mënyrë tjetër, Fryma e Shenjtë vepron vetëm në një atmosferë paqeje. *Paqja ka fuqi*. Unë besoj se kjo është arsyeja pse Gjoni 14:27 (AMP) na thotë se trashëgimia që Jezusi na lë është paqe. Jezusi tha: “Paqen po ju lë, paqen time po jua jap...”. Me fjalë të tjera, Ai na lë trashëgimi paqen e Tij.

Nëse keni një problem dhe djalli nuk arrin t’ju mërzisë për atë gjë, atëherë ai nuk ka asnjë fuqi mbi ju. Fuqia juaj gjendet në qëndrimin tuaj të qetë, paqebërës dhe plot besim. Djalli fiton fuqi kur arrin t’ju shkaktojë mërzitje dhe frikë.

Kur gjendeni në një situatë shqetësuese, qëllimi juaj duhet të jetë thjesht të qëndroni të qetë. Mos lejoni që mërzitja juaj t’ju fusë në lojë me djallin. Ai kënaqet kur ju mërzit emocionalisht. Zakonisht, gjëja e parë që një person i mërzitur bën, është të thotë gjëra që i japin djallit benzinë për t’ia hedhur zjarrin që sapo ka nisur.

Jakobi 3:5,6 (parafrazuar) thotë se gjuha është një pjesë e vogël, por që mund të nisë një zjarr të madh. Anëtarët tanë gjenden mes një bote të ligë që infekton dhe prish gjithë trupin dhe ky është është një zjarr i ndezur nga ferri. Nga ky Shkrim mund të shihni se djalli dëshiron që ju ta humbisni kontrollin në mënyrë që ta fitojë ai. Mos harroni, *djalli përpiket t'ju mërzisë*.

Tashmë mund ta keni vënë re se djalli punon orë shtesë kur ju bëheni gati të shkoni në kishë ose në studim biblik. Në shtëpinë tonë, të dielën në mëngjes dukej sikur binte një shpërthim i madh. Rrallë ia dilnim të shkonim në kishë pa pasur dikë të mërzitur, dhe zakonisht të gjithë ishim të mërzitur.

Të dielën në mëngjes, gjërat humbnin, derdheshin e thyheshin si asnjë ditë tjetër të javës. Fëmijët tanë, gjatë ditëve të javës shkonin mirë me njëri-tjetrin, por të dielën në mëngjes ata vetëm ziheshin. Sa më shumë zhurmë e trazira të kishim, aq më shumë mërzitesha unë. (Ju kujtohet, mua nuk më pëlqen zhurma e tepërt.)

Më në fund, filloja të ankohesha. Dave e urren ankesën, kështu pas pak, ai më thoshte të pushoja së ankuari. Atëherë unë mërzitesha me të. Për më tepër, fëmijët fillonin të qanin për shkak se Dave dhe unë po debatonim.

Në mes të gjithë kësaj gjullurdie, qeni fillonte të vraponte nëpër shtëpi me këpucën e njërit prej nesh në gojë dhe unë filloja të bërtisja: “Shpejt! Jemi shumë vonë!” Jam e sigurt se e njihni këtë skenë.

Kur lexova Jakobin 3:18 kuptova pse e gjithë kjo ndodhte pikërisht para se të dëgjonim Fjalën. Ky Shkrim thotë (AMP) “e korra e drejtësisë ...” (veprimet e drejta) “...është [fryti i farës] mbjellë” (Fjala) “në paqe nga ata që përpiqen dhe bëjnë paqen”.

Me fjalë të tjera, në mënyrë që Fjala e Perëndisë të lëshojë rrënjë dhe të prodhojë fryte të mira në jetët tona, ajo duhet të predikohet dhe të jepet mësim nga një njeri që është paqebërës. Por edhe ne duhet të kemi një qëndrim paqeje kur dëgjojmë Fjalën e Perëndisë.

Vetëm mendoni për jetën tuaj. Sa herë është armiku i suksesshëm në përpjekjet e tij për t’ju mërzhitur para se të dëgjoni Fjalën? Mos harroni të tregoni kujdes për makinacionet e tij dhe mos luani nën hundën e tij. E dyta e Korintasve 2:11 (AMP) thotë se “ne nuk jemi injorantë të dredhive dhe qëllimeve” të Satanit. Versioni ABS i quan ato “shfrytëzime”. Satani i përdor dredhitë për të mashtruar dhe për të keqdrejtuar. Le të tregohemi më të zgjuar se djalli.

E Para e Pjetrit 5:8 (AMP) thotë: “Jini të ekuilibruar mirë (të përmbajtur, të kthjellët në mendje), jini vigjilentë dhe të kujdesshëm gjithë kohën; sepse armiku juaj, djalli, endet rreth e qark si një luan turbullues [në uri të thellë], duke kërkuar dikë për ta kapur dhe për ta ngrënë.”

Mos lejoni që ai person të jeni ju! Ju nxis të tregoheni të kujdesshëm. Sa herë që filloni të ndjeheni të mërzhitur ose të irrituar, ndaloni dhe bëjini vetes këto pyetje: “Çfarë po përpiqet të bëjë djalli? Nëse u lë vend këtyre emocioneve negative, cili do të jetë rezultati?”

Efesianët 4:26, 27 (AMP) janë gjithashtu Shkrime shumë të rëndësishme që na mësojnë ta mbajmë djallin larg që të mos hedhë rrënjë në jetët tona duke mos na mërzhitur. Vargu 26 thotë “asnjëherë mos e lejoni zemërimin (irritimin, egërsinë apo indinjatën) tuaj të zgjasë derisa të perëndojë dielli”. Me fjalë të tjera “Mos qëndroni të zemëruar”.

Vargu 27 (AMP) thotë “Mos lini vend [të tillë] ose terren për djallin [mos i jepni asnjë mundësi atij]”. Kur jeni të mërzhitur e humbisni gëzimin. Kur e humbisni gëzimin, humbisni fuqinë tuaj. Nehemia 8:10 thotë: “. . . gëzimi i Zotit është fuqia juaj”. Psalmisti, Davidi, tek Psalmi 42:5 (ABS) flet për shpirtin e tij dhe thotë

“Pse ligështohesh, o shpirti im . . .?” Isaia 30:15 thotë “. . . forca juaj qëndron në qetësinë dhe në besimin tuaj . . .”. Pra, shikojmë përsëri se djalli dëshiron të na trazojë për të na vjedhur fuqinë.

Kam mësuar nga Fryma e Shenjtë se Ai punon në një atmosferë paqeje dhe jo në kohë trazirash. Djalli është ai që punon në kohë trazirash, por Fryma e Shenjtë vepron në paqe. Siguroni një atmosferë paqeje në shtëpinë, biznesin, kishën apo shërbesën tuaj. Ndërsa e bëni këtë, do të jeni duke nderuar Fjalën dhe Frymën e Perëndisë dhe do të mblidhni frytet e bindjes suaj.

Mos harroni, Jezusi i dërgoi të shtatëdhjetët dy nga dy për të bërë shumë vepra të mëdha, të dëbonin demonë, të shëronin të sëmurë dhe të predikonin Ungjillin. Ai u tha atyre të shkonin në një qytet, të gjenin një shtëpi, të flisnin paqe në të dhe të qëndronin aty. Nëse nuk pranoheshin (paqësisht), ata duhej të shkundnin pluhurin e këmbëve dhe të ecnin përpara (Luka 10:1-11, 17). Pse? Vepra e tyre do të ishte e pafuqishme nëse nuk qëndronin në paqe.

Jam e sigurt se po filloni të zbuloni mesazhin që ky libër ka si synim të tejçojë. *Bëni të pamundurën të ushtroni vetëkontroll për të qëndruar gjithmonë në paqe.*

Tek Luka 22:46, Jezusi na mëson të lutemi për të mos rënë në tundim. Ai u tha dishepujve (AMP): “. . . Ngrihuni dhe lutuni që të mos bini [fare] në tundim”. Mos u mbështesni në veten apo në fuqinë tuaj për t’i rezistuar djallit në këtë aspekt. Lutuni përditë që Perëndia t’ju japë hir t’i rezistoni djallit kur ai përpiqet t’ju vjedhë paqen. Kërkojini Zotit t’ju forcojë dhe t’ju ndihmojë.

Mos harroni, Gjoni 15:5 (AMP) thotë: “pa Mua . . . ju nuk mund të bëni asgjë”. Mos u përpiqni ta bëni vetë! Kërkoni ndihmë. Ju mund të bëni gjithçka nëpërmjet Krishtit (Fil. 4:13) por asgjë nga vetja juaj. Tek Gjoni 5:30 (AMP), madje edhe Jezusi thotë se Ai nuk do të bëjë asgjë nga vetja e Tij. Nëse doni që Perëndia t’ju ndihmojë, duhet të keni qëndrim të përulur. E para e Pjetrit 5:5 (ABS) thotë: “Perëndia i kundërshton mendjemëdhenjtë, por u jep hir të përulurve”.

Më lejoni të përmbledh duke thënë se Satani kërkon t’ju vjedhë paqen për t’ju vjedhur fuqinë tuaj. Ai ju do të dobësuar dhe të pafuqishëm, por unë ju inkurajoj “. . . fuqizohuni në Zotin dhe në forcën e pushtetit të tij” (Ef. 6:10). *Qëndroni në paqe!*

**QËNDRIMI I BESIMTARIT
GJATË PROVAVE**



6



QËNDRIMI I BESIMTARIT GJATË PROVAVE

Efesianëve 6:13 (AMP) thotë “. . . pasi të keni kryer gjithçka [kërkesat e krizës], për të qëndruar [me vendosmëri në vendin tuaj].” Cili është “vendi juaj”? Efesianëve 2:6 na mëson se vendi ynë është në *Krishtin*. Fjala *për të qëndruar* është përkthim i fjalës greke *histemi*¹. Një prej kuptimeve të saj është “banoj”. Fjala greke “*banoj*” tek Gjoni 15:7 është *meno*. Një prej kuptimeve është “qëndroj”². *Meno* ndonjëherë është përkthyer *qëndroj*³. Jezusi tha: “Në qoftë se qëndroni në mua dhe fjalët e mia qëndrojnë në ju, kërkoni çfarë të doni dhe do t’ju bëhet” (Gjoni 15:7, ABS). Vendi i qëndrimit është një vend fuqie.

¹. James Strong, “Greek Dictionary of the New Testament”, *Strong’s Exhaustive Concordance of the Bible*, (Abingdon: Nashville, 1890), f. 38, entry # 2476.

². Strong, *Concordance*, “Greek”, f. 47, # 3306.

³. W. E. Vine, *An Expository Dictionary of New Testament Words* (Old Tappan: Fleming H. Revell, 1940), Vol. IV, f. 70, 71.

Hebrenjve 4 thotë se kur ju i ndërprisni luftërat e në vend të tyre punoni (nëpërmjet besimit dhe bindjes) për të hyrë në prehjen e Perëndisë, *do të hyni në prehjen e Tij*. Në kohë sprove, bëni atë për të cilën ju drejton Perëndia, pastaj banoni dhe merrni qëndrimin tuaj *në Krishtin* dhe shikojeni Atë ndërsa punon për ju. Bibla thotë “. . . qëndroni dhe do të shikoni çlirimin e Zotit” (Eks. 14:13). Të gjitha këto fjalë—qëndroni, rrini të qetë, pushoni dhe në Krishtin—thonë të njëjtën gjë: *Mos e humbisni paqen!*

Filipianëve 1:28 (AMP) është një prej vargjeve më të fuqishme të Biblës që përcjell këtë çështje në mënyrë të fuqishme dhe të qartë. Ajo thotë:

“Dhe [për asnjë moment] mos u frikësoni e as mos u trembni nga asnjë armë e armiqve dhe kundërshtarëve tuaj, sepse ajo [qëndrueshmëria dhe guximi] do të jetë një shenjë e qartë (provë dhe vulë) për shkatërrimin [e afërt] të tyre, por [një shenjë dhe provë e sigurt] e çlirimit e shpëtimit tuaj, dhe kjo nga Perëndia”.

Ky varg e parashtron shumë qartë. *Qëndroni në paqe kur ju sulmojnë*. Kjo i tregon djallit se ai është i mundur. Ai nuk di çfarë të bëjë me ju nëse nuk arrin t’ju mërzisë. Ju gjithashtu mund të jeni të sigurtë për çlirimin e Perëndisë sepse qëndrimi në paqe e prehje i tregon Perëndisë se ju po veproni në besim të vërtetë. Hebrenjve 4 thotë se ata që hyjnë në prehjen e Perëndisë, tashmë kanë besuar.

Vazhdoni të shijoni jetën ndërsa Perëndia punon mbi problemet tuaja. Unë besoj se shumica e njerëzve mendojnë paqartësisht kur thonë se është gabim të gëzohesh kur ke probleme. Mbi të gjitha, nëse nuk mund të bësh asgjë tjetër, më e pakta që mund të bësh është të rrish mjeruar.

E di se në të kaluarën kam përjetuar shumë mendime të tilla. Kur unë dhe Dave kalonim ndonjë sprovë apo problem, ai gëzohej dhe e kënaqte veten. Unë isha e mjeruar dhe e mërzhitur me të sepse ai nuk ishte i mjeruar si unë.

Shpesh lufta jonë kishte natyrë financiare. Dave dukej se kishte një besim të mbinatyrshëm në fushën e parasë. Ai thoshte: “Ne japim të dhjetën dhe oferta bujare sipas nevojave që shohim. Bibla thotë të hidhni ‘gjithë merakun tuaj mbi të, sepse ai kujdeset për ju’ (1 Pj. 5:7). Bibla thotë se Perëndia do t’i plotësojë nevojat tona (Fil. 4:19), prandaj pse të shqetësohem? Shqetësimi nuk sjell asnjëherë para. Asnjëherë nuk ka sjellë.”

Ky ishte “qëndrimi” që mbante Dave. Ndërsa Perëndia vepronte mbi atë problem, Dave vazhdonte dhe e gëzonte jetën. Unë i thoja: “E di këtë Dave, por, nuk mund të rrish pa bërë asgjë”. Unë doja që ai të bënte diçka. Atëherë ai thoshte: “Në rregull Joyce, çfarë do që të bëj?” Unë i thoja: “Lutu! Ti duhet të lutesh.”

Ai thoshte: “E bëra. U luta dhe i kërkova Perëndisë të kujdesej për këtë problem. I kërkova të më tregonte nëse kishte ndonjë gjë që Ai dëshironte që unë të bëja. Nuk më ka treguar asgjë, kështu pra nuk e shoh asnjë arsye pse duhet të ndihem i mjeruar.

Thellë-thellë e dija se Dave kishte të drejtë. Megjithatë, diçka e turbullt vazhdonte të ngulmonte se nuk duhej të kisha guximin të gëzohesha ndërsa kisha probleme. Rezultati ishte i njëjtë për vite me rradhë: sa herë që kishim ndonjë problem, Dave lutej dhe qëndronte në paqe, kurse unë lutesha dhe shqetësohesha. E bëja veten të mjerueshme. Dave e shijonte jetën dhe Perëndia gjithmonë ia dilte mbanë në fund. Ne gjithmonë ia dilnim mbanë.

Faleminderit Perëndisë që në fund e kuptova se nuk po arrija asgjë. Gjithçka që po bëja ishte se po e ktheja veten në një njeri të mjeruar dhe ndoshta po e ngadalësoja përgjigjen që Perëndia dëshironte të më jepte. Tani unë i gëzohem *paqes në mes të stuhisë* (Marku 4:37-40).

Jezusi tha: “. . . në botë do të keni shtrëngim, por mermi zemër, unë e kam mundur botën” (Gjoni 16:33b). Bibla thotë gjithashtu se tundimi mund të vijë, por ne nxitemi të mos hyjmë në tundim (Luka 8:13; 1 Kor. 10:13; Jak. 1:12).

Thelbi i asaj që dua të them është se sfidat, gjërat që duhet të kalojmë, do të jenë gjithmonë të pranishme në këtë jetë, por ne jemi fitimtarë nëpërmjet Krishtit Jezus (Rom. 8:37).

Ne nuk jemi ish-fitimtarë, por do të jemi gjithmonë fitimtarë. Nuk do të arrini asnjëherë në një pikë ku tashmë t’i keni kaluar të gjitha pengesat, por mund të keni sigurinë se gjithmonë do të triumfoni në Krishtin. Ju gjithmonë do të jeni fitimtarë!

Do të vini në vendin për të cilën foli Pali tek Filipianëve 4:11, 12—ai tha se mësoi të ishte i kënaqur (në paqe) edhe në poshtërim, edhe në bollëk. Nëse ju nuk e mësoni këtë gjë, jeta juaj do të përbëhet nga një seri mërzitjesh të njëpasnjëshme. Kujtoni këtë: Nëse djalli arrin t’ju kontrollojë nëpërmjet rrethanave, ai do t’ju mbajë gjithë kohën nën këmbë. Ju mund të ecni në autoritetin tuaj duke qenë gjithmonë në paqe.

DITË PAS DITE



7



DITË PAS DITE

Një mënyrë e sigurt për të humbur paqen është të fillosh të mërzhitesh për të nesërmen. Mateu 6:34 (AMP) thotë:

“Prandaj mos u shqetësoni apo mos kini siklete për të nesërmen, sepse e nesërmja do të ketë shqetësimet dhe sikletet e veta. Secilës ditë i mjafton shqetësimi i vet.”

Shumë prej nesh kanë mjaft çështje për t’u kujdesur për ditën e sotme pa u shqetësuar akoma për të nesërmen. Perëndia do t’ju japë hir për të sotmen, por Ai nuk do t’ju japë hir për të nesërmen derisa e ajo të mbërrijë.

Shumë shpesh njerëzit shqetësohen vazhdimisht për diçka që nuk ndodh kurrë. Të gjitha “po sikur-et” janë shqetësime. Jini të kujdesshëm kur mendoni “po sikur” kjo apo ajo. Me siguri shqetësimi po ju tërheq në vetvete. Disa njerëz shqetësohen kaq shumë sa që shqetësimet kthehen në frikë dhe shpesh ndeshen pikërisht me gjërat nga të cilat kanë frikë.

Ne mund të marrim nga Perëndia nëpërmjet besimit, por gjithashtu edhe nga djalli nëpërmjet frikës.

Mos e lejoni veten të keni frikë për të nesërmen, por mbështetuni në njohurinë se Perëndia është besnik. *Çfarëdo gjëje të përmbajë e nesërmenja, është Ai që e mban të nesërmen.* Hiri i tij është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojën. Mos e shpërdoroni hirin e sotëm për ta kaluar ditën e sotme duke u shqetësuar për të nesërmen. Është me të vërtetë e mahnitshme ajo që mund të arrijmë në Krishtin nëse e jetojmë jetën ditë pas dite.

E mësova këtë gjë kur fillova të jepja mësim në kolegjin biblik. Jepja mësim një herë në javë në kishën time lokale ku isha gjithashtu edhe ndihmës-pastore. Kisha katër fëmijë dhe një punë me kohë të plotë kur m'u dha mundësia të jepja mësim kolegji biblik në kishë tri herë në javë. Kisha me të vërtetë shumë dëshirë të jepja më shumë mësim mbi Fjalën dhe ja ku ishte mundësia të jepja mësim tri herë në javë.

Megjithatë, ndërsa jepja mësim, më duhej edhe të studioja dhe të përgatitesha. Shumë prej orëve të mësimit ishin studime të thella biblike, që do thoshte shumë kërkime në Fjalë që unë të isha gati, veçanërisht në vitin e parë. Të gjitha studimet bëheshin mbrëmjeve, sepse unë punoja gjatë ditës. Nuk e dija se si mund t'ia dilja mbanë, por e ndjeja se Perëndia e donte nga unë këtë gjë.

Pas shumë lutjesh dhe mendimesh, hodha një hap përpara në Perëndinë për të bërë të pamundurën në Të. Gjëja kryesore që Zoti vazhdonte të theksonte ishte: “Ditë pas dite, kështu mund t’ia dalësh”. Nëse filloja të mendoja për të nesërmen, do të shqetësohesha shumë shpejt sepse menjëherë do të shikoja të pamundurën. E megjithatë, në secilën ditë, ditë pas dite, gjithçka funksiononte. Perëndia më dha hir, por ma dha vetëm kur erdhi dita për të cilën kisha nevojë për atë hir. Viti i dytë ishte shumë më i lehtë sepse i kisha të gjitha leksionet, prandaj nuk më duhej të studioja aq shumë sa në vitin e parë.

Kishte dy arsye themelore përse Zoti më kërkoi të ndërmerrija këtë detyrë, përveçse t’iu mësoja studentëve Fjalën. Njëra ishte të përjetoja në mënyrë të drejtpërdrejtë se sa shumë mund të arrihej nëpërmjet hirit të Perëndisë nëse jeta jetohet ditë pas dite. Tjetra ishte që unë të kisha eksperiencë në mësimdhënie aq të shpeshta. Sot, unë jap shumë shpesh mësim ndërsa bashkë me Dave udhëtojmë dhe gjithashtu bëjmë edhe takimet “Jetë në Fjalën” në shtëpinë tonë. Perëndia është i mirë dhe rrugët e tij janë të përsosura.

Të gjithë ne gabojmë. Po, sapo thashë se: “Të gjithë ne gabojmë!” Madje edhe ata njerëz për të cilët ju mendoni se nuk bëjnë asnjëherë asgjë të gabuar,

gabojnë. Bibla thotë se të gjithë ne kemi peshën shtypëse të gabimeve tona (Gal. 6:5) Të gjithë ne bëjmë dhe themi gjëra që do të donim të mos i kishim bërë apo thënë. Kur një gjë është bërë, është bërë.

Kam mësuar se në vend që ta humbas paqen për diçka që kam bërë, por që nuk mund ta ç'bëj dot më tani, duhet thjesht t'i besoj Perëndisë që ai të bëjë që gjithçka të funksionojë mirë. Ai e ka këtë aftësi dhe ju e dini këtë gjë. Ai mund t'i pastrojë gabimet tona.

Ndonjëherë them diçka që do të dëshiroja të mos e kisha thënë. Në vend që të shqetësohem nëse kam ofenduar dikë apo jo, i kërkoj Perëndisë t'i bëjë atyre të ditur se zemra ime ishte e drejtë edhe pse thashë fjalën e fundit në fillim. Unë besoj se Ai do të punojë në zemrat e tyre dhe do të më japë mua favor. Kështu, mua nuk më duhet të kaloj disa ditë duke u shqetësuar, pastaj të fshihem kur ta shikoj atë person.

Ne biem në kurthin e të ndjerit keqardhje për shumë gjëra. Unë dhe Dave hamë jashtë shumë shpesh sepse jemi shumë të zënë. Nganjëherë, hamë në ndonjë vend ku ushqimi ose shërbimi është i keq. Ndërsa ikim, e shikoj se pendohemi për orë të tëra që kemi shkuar në atë vend. Perëndia na tregoi se edhe keqardhja për zgjedhjen e gabuar të një restoranti, na e vjedh paqen.

Kujtohuni të gëzoni paqen, mos u përpiqni të bëni diçka për të cilën nuk mund të bëni asgjë. Nëse keni përkrahur një vend biznesi dhe i keni paguar faturat, keqardhja nuk i ndryshon dot faktet.

Tani, le t'i kthejmë situata të tilla përçark dhe t'i lëmë ato të veprojnë për mirë. Kështu mund të themi: “Mendo për njerëzit që do të shkojnë atje dhe nuk do të jenë të kënaqur. A nuk jemi të bekuar! Ne tashmë e kemi zbuluar se ai nuk është një vend për të shkuar. Nuk do të humbasim më as kohë dhe para përsëri atje.”

Unë kam një pllakëz muri që shkruan diçka të tillë: “Nëse përpiqesh të jetosh në të kaluarën, jeta do të bëhet e rëndë.” Jezusi nuk tha se është “Unë kam Qenë”-i i madh. Nëse përpiqesh të jetosh në të ardhmen, jeta do të jetë e rëndë. Jezusi nuk tha se Ai është “Unë do të Jem”-i i madh. Nëse e merr secilën ditë ashtu siç vjen, jeta do të funksionojë mirë. Jezusi tha: “Unë Jam” (Gjoni 8:58). Ai është gjithmonë me ju në çdo situatë që ju gjendeni. Thjesht kujtohuni të besoni në Të në hirin e mjaftueshëm për ditën e sotme.

LUTJA SJELL PAQE



8



LUTJA SJELL PAQE

Filipianëve 4:6 thotë:

“Mos u shqetësoni për asgjë” (mos kini ankth); “por në çdo gjë me lutje dhe kërkesa, me falënderime bëjani të ditura kërkesat tuaja Perëndisë”.

“Dhe paqja e Perëndisë, që e tejkalon gjithë arsyetimin, do të ruajë zemrat dhe mendjet tuaja nëpërmjet Krishtit Jezus”.

Është e mrekullueshme të përjetosh paqen që ia kalon çdo arsyetimi. Kur, sipas gjithë rrethanave duhet të jeni të mërzitur, në panik, në dhimbje dhe në shqetësim, ju ende e keni atë paqe të pashpjegueshme. Kjo është një përvojë e mrekullueshme. Bota është e uritur për këtë lloj paqeje. Ju nuk mund ta blini sepse nuk është në shitje. Ajo është një dhuratë falas nga vetë Jezusi dhe bëhet e juaja kur ju e pranoni Atë si Zot dhe Shpëtimtar dhe mësoni të ecni sipas parimeve të Tij.

Lutja e përkushtimit është një lutje e fuqishme e cila e lëviz barrën nga ju tek Jezusi. E Para e Pjetrit 5:7 thotë: “Duke hedhur gjithë merakun tuaj mbi të, sepse ai kujdeset për ju”. Përkthimi AMP e 1 Pjetrit 5:7 thotë:

“Duke hedhur gjithë përkujdesjen tuaj [gjithë frikërat, gjithëshqetësimet, gjithëproblemet, njëherë e përgjithmonë] mbi Të, sepse Ai kujdeset për ju me dhembshuri dhe kujdeset për ju me vigjilencë”.

Çfarë privilegji! Shumë të krishterë nuk e përdorin kurrë këtë përfitim të madh edhe pse iu përket atyre.

A jeni duke e shijuar paqen që mund të keni kur i hidhni të gjitha shqetësimet tuaja mbi Të? Fjala *hedh* do të thotë të flakësh ose të hedhësh me furi. Sa më shpejt ta bëni këtë gjë, aq më mirë do të jetë. Këtë gjë ju mund ta bëni nëpërmjet lutjes. Parashtrojani problemet tuaja përkujdesjes së Tij të dashur. Bëjeni këtë menjëherë sapo Fryma e Shenjtë t’ju ndërgjegjësojë se po shqetësoheni apo se keni humbur paqen.

Djalli dëshiron që ju të shqetësoheni. E Para e Pjetrit 5:9 (AMP) thotë “rezistojini” djallit “ndaj sulmeve të tij”—që do të thotë menjëherë, që në fillim të sulmit. Mos prisni që ai të ketë mundësi t’ju mposhtë për disa ditë. Sa më gjatë të prisni t’i rezistoni, aq më e fortë do të bëhet qëndresa e djallit brenda jush.

Atëherë do të jetë më e vështirë të liroheni prej tij. Sapo e kuptoni se po shqetësoheni, refuzojeni këtë shqetësim. Hidhjeni përkujdesjen e kësaj situatë mbi Perëndinë. *Ndryshoni mënyrën e mendimit.*

Kur po mësoja për herë të parë parimin të “hidhja barrën” dhe “të mos shqetësohesha”, e dija se mënyra ime e të menduarit ishte e gabuar. Mund ta kaloja gjithë ditën duke hedhur poshtë mendime dhe ato më ktheheshin mbrapsht menjëherë. Më kujtohet se isha shumë e irrituar me gjithë situatën. Kështu i thashë Zotit: “Si ka mundësi që njeriu të mos mendojë për diçka?” Shihni pak, që të mos shqetësoheni, nuk duhet të mendoni rreth problemit. Kur mendoni për të ndërmarrë ndonjë vendim, ju duhet të mendoni pozitivisht për të dhe jo negativisht. Mund të jeni realistë për problemin tuaj dhe jo negativë.

Akoma e mbaj mend si sot, atë që më tha Jezusi kur e pyeta: “Si ka mundësi që nuk resht së menduari për këtë problem?” Ai më tha: “Është shumë e thjeshtë, Joyce. Thjesht mendo për diçka tjetër.” E kuptoni, nuk mund të mendoni për problemin nëse mendoni për diçka tjetër që nuk është problem.

Filipianëve 4:6 thotë të mos shqetësohemi, por përkundrazi të lutemi. Vargu 7 premtan se nëse bëni vargun 6, do të keni paqen që tejkalon çdo arsye. Vargu 8 (AMP) thotë:

“Dhe tani, vëllezër, çfarëdo që është e vërtetë, çfarëdo që është e vlefshme për nderim, e respektueshme dhe e përshtatshme, çfarëdo që është e pastër, çfarëdo që është e këndshme dhe e dashur, çfarëdo që është e sjellshme dhe tërheqëse dhe shpirtmirë, nëse ka ndonjë virtyt dhe përsosmëri, nëse ka ndonjë gjë të vlefshme për lëvdim, mendoni . . . këto gjëra . . .”.

Unë tani lutem që Perëndia t’ju japë hir, i cili është fuqia e Frymës së Shenjtë, që t’i vendosë këto parime në praktikë në jetën tuaj në mënyrë që të gëzoni bekimin e jetës në paqe. Unë gjithashtu lutem që Ati të mund të ketë mbështetjen tuaj për t’ju përdorur për nderin e lavdinë e Tij.

PËRJETONI NJË JETË TË RE



Në qoftë se nuk e keni ftuar asnjëherë Jezusin të jetë Zoti dhe Shpëtimtari juaj, unë ju ftoj ta bëni këtë tani. Ju mund të bëni këtë lutje dhe nëse jeni me të vërtetë të sinqertë për të, do të përjetoni një jetë të re në Krishtin.

Atë Perëndi, unë besoj se Jezu Krishti është Biri Yt, Shpëtimtari i botës. Unë besoj se Ai vdiq në kryq për mua dhe Ai mbarti të gjitha mëkatet e mia. Ai pagoi çmimin për mëkatet e mia. Ai mori dënimin që unë meritoja. Unë besoj se Jezusi u ringjall prej së vdekurish dhe tani është i ulur në krahun Tënd të djathtë. Unë kam nevojë për Ty, Jezu. Më fal mëkatet e mia, më shpëto, eja të jetosh brenda meje. Unë dua të rilindem përsëri.

Tani beso se Jezusi po jeton në zemrën tënde. Ju jeni falur, jeni drejtësuar dhe kur Jezusi të vijë, do të shkoni në qiell.

Gjeni një kishë të mirë që mëson Fjalën e Perëndisë dhe filloni të rriteni në Krishtin. Asgjë nuk do të mund të ndryshojë në jetën tuaj pa njohurinë e Fjalës së Perëndisë. Gjoni 8:31, 32 AMP thotë: “Nëse do të qëndroni në fjalën Time . . . jeni me të vërtetë dishepujt e Mi. Dhe ju do ta njihni të Vërtetën, dhe e Vërteta do t’ju bëjë të lirë”.

Më shkruani dhe më njoftoni nëse e keni pranuar Jezusin dhe kërkonte një broshurë falas se si të filloni jetën tuaj të re në Krishtin.

I gjithë grupi “Jetë në Fjalën” ju do. Ne lutemi që të jeni bekuar nga ky libër që flet mbi paqen.

I dashur,

Gjoni 8:31,32 APM thotë: “Nëse do të qëndroni në fjalën Time . . . jeni me të vërtetë dishepujt e Mi. Dhe ju do ta njihni të Vërtetën, dhe e Vërteta do t’ju bëjë të lirë”.

Unë ju nxis të merrni Fjalën e Perëndisë, ta mbillni thellë në zemrën tuaj dhe sipas 2 Korintasve 3:18, ndërsa shikoni në Fjalë, do të shndërroheni në shëmbëmllyrën e Jezu Krishtit.

*Me dashuri
Joyce*

RRETH AUTORES



JOYCE MEYER është një nga mësueset kryesore praktike të Biblës në botë. Si autorja Nr.1 më e shitur e gazetës *New York Times* ajo ka shkruar më shumë se tetëdhjetë libra frymëzues, përfshirë këtu *Kurrë Mos u Dorëzo*, *Sekreti i Kënaqësisë së Vërtetë*, *100 Mënyra për të Thjeshtëzuar Jetën Tënde*, gjithë grupin e librave *Fushëbeteja e Mendjes*, si dhe nismën e saj në gjininë e romanit me titullin *Qindarka dhe Çdo Minutë*, dhe shumë të tjerë. Ajo gjithashtu ka transmetuar mijëra mësimë audio, dhe ka tashmë një bibliotekë të plotë në video. Programet radio-televizive të Joyce Meyer, *Të Shijosh Jetën e Përditshme*® transmetohen në mbarë botën, ndërkohë që ajo udhëton shumë për të mbajtur konferenca. Mesazhet e saj, ju mund t’i ndiqni në disa gjuhë të ndryshme në **tv.joycemeyer.org**. Joyce dhe bashkëshorti i saj, Dave, janë prindërit e katër fëmijëve të rritur dhe banojnë në St. Louis, Missouri.

Për të kontaktuar me autoren shkruani tek:

Shërbesa Joyce Meyer, Shqipëri
c/o AEP Box 50, KP 119
Tiranë
ose telefononi: 0692055966

Ju lutemi, kur të shkruani, përfshini dëshminë tuaj ose ndihmën që keni marrë prej këtij libri. Kërkesat tuaja të lutjes janë të mirëpritura.

Në SHBA, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries
P.O.Box 655
Fenton, MO 63026
USA
(636) 349- 0303
www.joycemeyer.org

Në Kanada, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— Canada
Lambeth Box 1300
London, ON N6P 1T5
CANADA
1- 800- 727- 9673

Në Australi, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— Australia
Locked Bag 77
Mansfield Delivery Centre
Queensland 4122
AUSTRALIA
(07) 3349 1200

Në Angli, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— England
P.O. Box 1549
Windsor SL4 1GT
UNITED KINGDOM
01753 831102

Në Afrikën e Jugut, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— South Africa
P.O. Box 5
Cape Town 8000
SOUTH AFRICA
(27) 21- 701- 1056

LIBRA NGA
JOYCE MEYER NË SHQIP

Fushëbeteja e Mendjes

Kur, o Zot, Kur?

Një Mënyrë e Re Jetese

*Paqe**

Pse, o Zot, Pse?

Revolucioni i Dashurisë

Thuaji Se i Dua

JEPJANI PROBLEMET TUAJA PERËNDISË . . . DHE AI DO T'JU JAPË JUVE PAQE DHE GËZIM!



A po përpiqeni të bëni të pamundurën? A po stërmundoheni për të ndryshuar njerëzit rreth jush? Mos ndoshta nuk jeni të lumtur sepse nuk jeni aty ku dëshironi të jeni frymërisht? A po e humbisni paqen? Nëse nuk keni paqe, nuk mund ta shijoni jetën. Tani, Joyce Meyer ju tregon se si të fitoni kontroll në ekzistencën tuaj të përditshme . . . ndërsa gjeni paqe në

mes të stuhisë. Ajo do t'ju mësojë se si:

- Të prisni për Perëndinë dhe për kohën e Tij të përsosur
- T'ua kaloni “vjedhësve të paqes” që përpiqen t'ju mërzhisin
- Të gjeni paqe me një qëndrim të qetë dhe besues
- Të përqendroheni në hirin e sotëm dhe jo në shqetësimet e së nesërme.

Paqja e Perëndisë ia kalon çdo arsyesimi. Ajo është dhurata e tij dhënë falas për ju. A jeni gati për ta marrë?



JOYCE MEYER
MINISTRIES